

Hyrje

Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të prodhojë statistika zyrtare për trendet sociale dhe ekonomike në shoqërinë e Kosovës. Për të arritur këtë objektiv, ASK-ja vepron në përputhje me parimet ndërkombëtare mbi statistikat zyrtare, të miratuara nga Bashkimi Evropian dhe Kombet e Bashkuara.

Në këtë kontekst, politika e diseminimit e ASK-së bazohet në parimet: pavarësia, qasja, besueshmëria dhe relevanca – dhe ka si objektiv arritjen, sa më shumë që është e mundur, e koherencës dhe relevancës për përdoruesit. Mediat e lajmeve janë një grup caku me prioritet të veçantë për sa i përket diseminimit.

Pavarësia

Statistikat duhet të jenë të paanshme. Shifrat, analizat dhe tekstet shpjeguese përgatiten në mënyrë objektive dhe të pavarur nga interesat politike dhe ekonomike. Këtë e siguron statusi i pavarur i ASK-së.

Datat e publikimit të statistikave paralajmërohen në kalendarin e publikimeve në webfaqen e ASK-së. Kjo siguron që të mos ketë ndikim politik në kohën e publikimeve të rezultateve statistikore.

Qasja

Të gjitha statistikat e publikuara janë në dispozicion në webfaqen e ASK-së dhe databaza ASKData do të përditësohet vazhdimisht me të dhëna. Statistikat mund të përdoren dhe citohen, duke theksuar që burimi është ASK-ja.

Rezultatet statistikore duhet të jenë në dispozicion për të gjithë përdoruesit në të njëjtën kohë.

Statistikat ofrohen bashkë me qasjen në dokumentacionin mbi metodologjinë, cilësinë dhe konceptet, në formë të deklaratave të cilësisë. Kjo formë do të vlejë për të gjitha statistikat nga viti 2017.

Besueshmëria

Pasqyra, që ofrohet nga statistikat, për trendet sociale dhe ekonomike, duhet të jetë e besueshme. Nëse gjenden gabime në statistikat e publikuara, korrigjimet përkatëse publikohen sa më shpejt që është e mundur. Nëse ka gabime në publikimet e shtypura, bëhet një listë e gabimeve dhe dorëzohet me publikimin. Versionet elektronike korrigjohen në atë mënyrë që korrigjimi bëhet i dukshëm dhe vendoset njoftimi në webfaqen e ASK-së –duke filluar nga fundi i vitit 2016 kur webfaqja e re e ASK-së është online.

Nëse ASK-ja identifikon ndonjë keqkuptim ose keqinterpretim të shifrave nga ana e mediave, kontakton mediat dhe I ofron ndihmë në korrigjimin e gabimit.

Konfidencialiteti

Kur publikohen statistikat sigurohet që nuk mund të identifikohet asnjë biznes ose individ.

Koherenca

ASK-ja përdor disa kanale diseminimi për statistikat: buletine, publikime, media sociale etj. Për të siguruar përputhshmëri në të gjitha kanalet e diseminimit, përdoret struktura e njëjtë e fushave, që mundëson lidhjen nga përmbajtja e përgjithshme tek tabelat dhe dokumentet më të detajuara dhe tek statistikat e një fushe të caktuar.

Relevanca

Për të siguruar që statistikat shpërndahen në atë mënyrë që përputhet me kërkesat e përdoruesve, do të realizohen anketa mbi kënaqshmërinë e përdoruesve. Takime me grupet e interesit gjithashtu përdoren për identifikimin e kërkesave të përdoruesve.